



REPUBLIKA E KOSOVËS

ODA E NOTERËVE TË KOSOVËS

Nr.....Prot. Datë:11/03/2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE

Nr.....Prot. Datë:11/03/2016

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Dhoma Kombëtare e Noterëve të Republikës së Shqipërisë, (*referuar si pala*), e cila është Autoriteti kompetent për qëllimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

DHE

Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës, (*referuar si pala*), e cila është Autoriteti kompetent për qëllimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

DUKE MARRË NË KONSIDERATË

qëllimin e përbashkët për bashkëpunimin ndërmjet noterëve të të dyja vendeve;

DUKE KONSIDERUAR

që ky bashkëpunim do të rezultojë në një kontribut efektiv dhe vlerë e shtuar në veprimtarinë e noterëve të të dyja vendeve;

DUKE JU REFERUAR

Legjislacionit në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e të dyja paleve;

DUKE JU REFERUAR

Ligjit nr. 7829, dt. 01.06.1994, "Për Noterinë", me ndryshimet përkatëse, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Ligji 03/L-010 "Për Noterinë" miratuar nga Kuvendi i Republikës Kosovës

Bien dakort për sa më poshtë;

Neni 1

Qëllimi

1.1 Palët me anë të këtij memorandum bashkëpunimi kanë për qëllim të vendosin një bashkëpunim të ndërsjelltë e të frutshmëm ndërmjet tyre.

Neni 2

Angazhimet e palëve

2.1 Palët angazhohen që të bashkëpunojnë në këto drejtime dhe në mënyrë të veçantë:

- Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke akte, literaturë juridike, materiale të ndryshme që kanë të bëjnë me ligje të reja, rregullore e udhëzime të kësaj fushe;
- Të organizojnë shkëmbime profesionale nëpërmjet formimit teknik – juridik e profesional , për të realizuar një njohje reciproke të dispozitave që rregullojnë veprimtarinë noteriale në të dyja vendet si dhe redaktimin e akteve noteriale;
- Të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta për përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve, që burojnë nga legjislacioni civil në vendet dhe ligjet përkatëse;
- Të ndërmarrin studime e projekte të përbashkëta për përafrimin e praktikave;
- Të organizojnë çdo formë tjetër të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve në funksion të përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 3

Detyrime të Dhomës Kombëtare të Noterëve të Republikës së Shqipërisë

3.1 Realizon në vijimësi sensibilizimin e noterëve për bashkëpunimin dhe punën e përbashkët me noterët e Republikës së Kosovës;

3.2 Realizon njohjen e anëtarëve të saj me praktikën e punës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në Republikën e Kosovës;

3.3 Sensibilizon antarët e saj për njohjen e “Ligjit Mbi Noterinë “ në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Detyrime të Odes së Noterëve të Republikës së Kosovës

- 4.1** Realizon në vijimësi sensibilizimin e noterëve për bashkëpunimin dhe punën e përbashkët me noterët e Republikës së Shqipërisë;
- 4.2** Realizon njohjen e anëtarëve të saj me praktikën e punës për regjistrimin e pasurive të paluajtëshme në Republikën e Shqipërisë;
- 4.3** Sensibilizon antarët e saj për njohjen e ligjit " Për Noterinë " në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Koordinimi ndërmjet palëve

- 5.1** Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit;
- 5.2** Komunikimi mes paleve do të jetë në formë shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.

Neni 6

Dispozitat e fundit


- 6.1** Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar;
- 6.2** Marrëveshjes mund t'i bëhen ndryshime nga Palët nëpërmjet komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi të tyre;
- 6.3** Kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim, palën tjetër;
- 6.4** Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplare origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Dhomën Kombëtare të Noterëve të Republikës së Shqipërisë dhe dy ekzemplare origjinal depozitohen në Odën e Noterëve të Republikës së Kosovës.

Nënshkruhet sot me datë : 11/03/2016, në Tiranë.

**PËR DHOMËN KOMBËTARE TË NOTERËVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

PRESIDENTE

MIMOZA SADUSHAJ



**PËR ODËN E NOTERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

PRESIDENTE

ARBENA SHEHU

